



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Nënkomisioni parlamentar “Për ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat””

PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.09.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Nënkomisionit

Rendi i Ditës:

- 1.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 06.02.2019
- 2.Raportimi për vijueshmërinë e procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, pas ndryshimeve të fundit në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat””.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Elona Hoxha, Sadi Vorpsi dhe Ylli Shehu.

Mungojnë:

Myslim Murrizi dhe Alban Zeneli.

Të ftuar:

Ana Kapaj - Kryetare e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj - Mirëmëngjesi!

Faleminderit për prezencën!

Sot kemi njoftuar mbledhjen e Nënkomisionit Parlamentar për Ndjekjen e Zbatimit të Ligjit nr.12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, i njohur ndryshe si ligji për vetingun në radhët e Policisë së Shtetit. Në rendin e ditës kemi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së datës 06.02.2019. A ka ndonjë nga kolegët vërejtje për procesverbalin? Jo, nuk ka.

Miratohet.

Pika e dytë e rendit të ditës është raportimin për vijueshmërinë e procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, pas ndryshimeve të fundit në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat””.

Për të na informuar për vijueshmërinë e procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit ne kemi të ftuar kryetaren e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, zonjën Ana Kapaj, e cila vjen e shoqëruar nga sekretarja e Përgjithshme, zonja Marjeta Perlala. Ndërkohë dua t’ju bëj me dije se në këtë mbledhje ishte ftuar edhe zëvendësministri i Brendshëm, i cili mbulon këtë çështje dhe dua të përfitoj nga rasti t’i kujtoj përfaqësuesit të këtij institucioni dhe kujtdo tjetër që paraqitja në komisionin parlamentar, në çdo komision parlamentar, nuk është diskrecionale, në qoftë se komisioni e kërkon, secili drejtues është i detyruar të paraqitet në komisionin parlamentar.

Përpara se t’ia kaloj fjalën kryetares së Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, dua të bëj një përmbledhje të shkurtër të veprimtarisë së nënkomisionit parlamentar duke qenë se këtij komisioni i janë bashkuar rishtaz edhe anëtarë të opozitës, ku ne sot kemi vetëm zotin Ylli Shehu.

Në datën 19 korrik të vitit 2018 Kuvendi i Shqipërisë ka ngritur nënkomisionin parlamentar për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”. Ky nënkomision ka të njëjtën natyrë funksionimi dhe, pak a shumë, të njëjtën përbërje siç edhe nënkomisionet e tjera në Republikën e Shqipërisë, përveç faktit se është në përbërje të komisionit të përhershëm të Kuvendit, komisionit tonë,

Komisionit për Sigurinë Kombëtare. Fusha jonë e përgjegjësisë është ndjekja dhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjit nr.12/2018. Në një nga pikat e vendimit përkatës të Kuvendit për ngritjen e këtij nënkomisioni përcaktohet se ky nënkomision përbëhet nga 7 anëtarë. Besoj se për median dhe publikun është e ditur që ky komision në fillimet e veta ka funksionuar vetëm me anëtarët e maxhorancës, sepse edhe pse një pjesë e opozitës kërkoi që ligji të parashikonte ngritjen e këtij nënkomisioni, në qëndrimet e mëvonshme nuk u përfaqësua me asnjë anëtar. Ardha e opozitës së re në Kuvendin e Shqipërisë bëri të mundur edhe plotësimin e numrit të këtij nënkomisioni, duke pasur aktualisht në përbërje zonjën Ermonela Felaj, kryetare e komisionit, zotin Myslim Murrizi, nënkryetar i komisionit, Grupi Parlamentar Demokrat, zonjën Elona Hoxha, anëtare e Partisë Socialiste, zotin Sadi Vorpsi, përfaqësues i Partisë Socialiste, zoti Alban Zeneli, Grupi Parlamentar Demokrat dhe zoti Ylli Shehu, anëtar i pavarur.

Dua t'ju kujtoj se në momente të caktuara puna e këtij komisioni nuk ka qenë e mundur edhe për shkak të kuorumit, sepse një nga anëtarët e këtij komisioni, zoti Pjerin Ndreu, e ka dorëzuar më herët mandatin e deputetit, për t'iu nënshtuar zgjedhjeve lokale. Sidoqoftë, ky nënkomision, duke marrë parasysh të gjithë ecurinë e hyrjes në fuqi dhe zbatimit të ligjit, ka zhvilluar mbledhjen në datën 21 shtator 2018, mbledhje në të cilën është bërë konsultimi i nënkomisionit dhe është zgjedhur sekretari i tij, që është zoti Vorpsi, dhe në datën 1 tetor 2018 me të njëjtin rend dite, me të cilin ne jemi duke u ballafaquar edhe sot. Po kështu, në datën 6 shkurt të vitit 2019 është zhvilluar e njëjta mbledhje, në të cilën komisioni është njohur me veprimtarinë e bordit të përzgjedhjes së anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe anëtarëve të sekretariatit teknik nga periudha e fundit e raportimit.

Sipas informacionit që ne kemi marrë gjatë kësaj kohe, Ministria e Brendshme, me hyrjen në fuqi të ligjit, ka marrë masat përkatëse për sa i takon ngritjes së strukturave që do të vijonin procesin e vlerësimit të të gjithë punonjësve të Policisë së Shtetit, duke u ngritur bordi i përzgjedhjes, në të cilin Avokati i Popullit ka caktuar si përfaqësues të tij zotin Fatbardh Zenelaj, që është edhe sekretar i Përgjithshëm i këtij institucioni, nga Shërbimi Informativ u caktua si përfaqësues zoti Gjergji Semani, me detyrë drejtor në Shërbimin Informativ, nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale u caktua zonja Ardita Shehaj, me detyrë drejtoreshë e për të Drejtën e Informimit dhe anëtar i pestë i bordit ishte zonja Ardjana Hala, e cila përfaqëson Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Pra, ligji nuk ka filluar menjëherë nga zbatimi konkret dhe real i tij, që në thelb të tij ka vlerësimin e të dhënave për çdonjërin nga punonjësit e Policisë së Shtetit, por duhej që në fillim të përzgjidhej bordi. Në datën 20.06.2018 bordi, pasi ka marrë në intervistë kandidatët, të cilët kanë aplikuar për të qenë pjesë e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, ka bërë edhe renditjen e

kandidaturave. Ndërkohë që komisioni ka qenë i informuar në mënyrë informale ose jopublike për kandidaturat dhe renditjen e tyre, ka kaluar një kohë deri në përgatitjen e VKM-së nr. 14, e cila ka hyrë në fuqi më 23 janar të vitit 2019 “Për trajtimin financiar të anëtarëve të bordit përzgjedhës të komisionit të jashtëm të vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, po kështu edhe palën e anëtarëve të sekretariatit teknik që ngrihet pranë këtij komisioni.

Në kushtet në të cilat u miratuar kjo VKM, pra për shpërblimin e punës që do të duhet të bëjnë në të ardhmen dhe po bëjnë anëtarët e komisionit të jashtëm dhe sekretariati teknik, është mbledhur menjëherë bordi përzgjedhës, i cili ka njoftuar se cilët kanë qenë anëtarët fitues dhe, natyrisht, pjesë të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe sekretariatit dhe u është bërë me dije edhe paga për këto pozicione.

Po e bëj këtë ndalesë të shkurtër për të kuptuar që puna e nënkomisionit, në fakt, ka qenë e lidhur me ecurinë e ligjit dhe është pazgjidhshmërisht kështu. Kështu që, për sa kohë puna nuk fillonte konkretisht për shkak të problemeve të përcaktimit të pagesës së anëtarëve të komisionit të jashtëm të vlerësimit e të tjera, sigurisht që edhe ne kemi qenë të limituar për të zhvilluar mbledhje të tilla.

Ne duhet ta pranojmë që elementi financiar ka qenë një nga momentet që, në fakt, ka sjellë vonesa në implementimin e këtij ligji.

Ministria e Brendshme, pasi kreu një analizë të thellë, ka ardhur në komisionin parlamentar në Kuvendin e Shqipërisë duke propozuar një mekanizëm të ri për vlerësimin (pra, thënë ndryshe, propozojnë ndryshim të ligjit), në mekanizëm, i cili, në gjykimin e Ministrisë së Brendshme, por edhe në gjykimin tonë si deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, sepse ne e kemi mbështetur, arrin po ato objektiva që parashikoheshin edhe më parë, sa i takon vetingut të punonjësve të Policisë së Shtetit, por me një kosto shumë herë më të ulët se sa ajo fillestare.

Këto ndryshime janë miratuar në muajin prill 2019 dhe, në momentin më të parë, Presidenti i Republikës nuk i dekretoi ato ndryshime. Ai e riktheu ligjin për rishqyrtim. Ne kemi qenë së bashku në seancën përkatëse dhe vetëm pas rrëzimit të dekretit kuptohet që ligjit iu hap drita jeshile për të filluar nga zbatimi real i tij.

Kujtoj që në ligj u bënë dy ndryshime thelbësore, të cilat në fakt nuk e preknin dhe nuk e prekin thelbin e kriterëve të vlerësimit dhe procedurës që duhet të ndiqet fillimisht nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit.

Punonjësit e SHÇBA-së do të kalojnë të gjithë vlerësimin në fazën e parë. Ligji i miratuar më parë parashikonte që vetëm drejtori i përgjithshëm, zëvendës drejtori, drejtorët dhe shefat e sektorëve e kalonin vlerësimin në fazën e parë.

Vlerësimi i fazës së parë kryhet nga një komision i jashtëm, i cili ka 15 anëtarë që asistohet nga një sekretariat në po të njëjtën shifër, pra 15 vetë.

Në fazën e dytë dhe të tretë, tanimë dihet që vlerësimin e punonjësve të Policisë së Shtetit, pra vetingun e tyre do ta kryejë SHÇBA-ja, pasi gjithë anëtarët e këtij shërbimi i nënshtrohen vlerësimit nga ana e Komisionit të Jashtëm të vlerësimit dhe të gjithë ata që do ta kalojnë pozitivisht këtë do të jenë pjesa që do të vijojë vetimin në radhë të tjera.

Komisioni i Jashtëm i vlerësimit ushtron veprimtarinë e tij deri në përfundimin e procesit të vlerësimit për kategorinë përkatëse të punonjësve që janë gradat e larta kryesisht, dhe koha, të cilën ne si komision i kemi lënë në dispozicion ose ligji tanimë i ka lënë në dispozicion këtij komisioni për të kryer këtë detyrë është 1 vit nga dita e hyrjes në fuqi të ndryshimeve të fundit që u bënë në ligj.

Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit ka filluar punën me verifikimin e dosjeve. Siç e shpreha edhe pak më sipër, komisioni përbëhet nga 15 anëtarë dhe mbështetet nga një sekretariat teknik ipërbërë nga po kaq anëtarë, pra 15 anëtarë.

5 anëtarë të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit kanë ardhur nga konkurrimi i hapur, 5 kanë ardhur nga trupa pedagogjike dhe 5 janë caktuar nga Inspektorat i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

Kjo është edhe arsyeja pse ky komision ruan këtë emërtim, Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, sepse në përbërje të tij nuk ka asnjë prej punonjësve që bëjnë pjesë në të gjithë strukturën e madhe të punonjësve të PSH-së.

Për të njohur edhe publikun, anëtarët e KJV-së janë: zonja Ana Kapaj, të cilën kemi rastin ta kemi për herë të parë në nënkomisionin tonë si kryetare, Artur Baku, Alban Laska, Adriana Meko, Bledar Ilija, Elvira Dabërdaku, Elida Liko, Ela Kërka, Ledian Rusta, Luljeta Qoku, Marjeta Gjela, Mirela Ujkani Miti, Nertila Sadedini, Sonila Kadareja dhe Zamira Gjini.

Pra, këta janë anëtarët e KJV-së, që tanimë e kanë filluar punën. Ne kemi qenë të njoftuar, në fakt, si nënkomision parlamentar, që në ditën e parë të hedhjes së shortit për zgjedhjen e dosjeve të para që do të kalojnë në filtrin e trupave përkatëse që janë në përbërje të KJV-së, ne të ishim pjesëmarrës. Në fakt, sekretari i këtij nënkomisioni, zoti Vorpsi, ka qenë gjatë zhvillimit të procedurës së shortit.

Megjithatë, për t'u njohur më hollësisht me fillimet e punës së këtij komisioni, me ngarkesën që ky komision ka aktualisht, sigurisht edhe me vështirësitë që ndesh në punën e tij, sepse duhet kuptuar që është një ligj i ri, implementimi i të cilit nuk është kaq i thjeshtë, sepse ka kërkuar një kohë edhe të trajnimit të të gjithë punonjësve që janë përfshirë në KJV dhe ka shumë rëndësi që faza e parë të kryhet shumë mirë; jo vetëm se është zemra e procesit se

vetohen gradat më të larta, por edhe për të krijuar traditën e punës, mekanizmin e palëvizshëm të punës, të cilin do të duhet ta vijnë të gjithë punonjësit e tjerë të SHÇBA-së, që do të kalojnë vetingun; pra, për të gjitha këto, unë do të ftoj zonjën Kapaj që të na informonte.

Për publikun dhe për mediet procedura është e njohur. Pasi zonja Kapaj do të na paraqesë informacionin e saj, antarët e nënkomisionit kanë të drejtën të bëjnë pyetje dhe diskutime.

Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Kapaj!

Ana Kapaj – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, gjithashtu, anëtarëve të këtij nënkomisioni!

Së pari, e vlerësoj maksimalisht ftesën që na është bërë sot dhe mendojmë fort se ka ardhur koha dhe është momenti i përshtatshëm që ju si nënkomision të informoheni për ecurinë tonë dhe, gjithashtu, opinioni publik dhe mediet të informohen për atë çka bërë deri më sot ky komision.

Informacioni që ne si komision kemi përgatitur për ju sot lidhet kryesisht me ecurinë e punës sonë, hapat që kemi ndjekur dhe disa problematika që na kanë dalë gjatë këtij procesi.

Gjithashtu, dëshiroj t'ju sjell në vëmendje që, nëse gjatë seancës së pyetjeve që anëtarët e nënkomisionit mund të kenë, rrisohen të preken momentet e hetimit tonë, unë do të kërkoja që në atë moment të bëhej mbledhja me dyer të mbyllura. Nëse do të ketë një moment të tillë.

Ju faleminderit!

Ana Kapaj – Ashtu sikundër e përshkroi edhe zonja kryetare në fjalën e saj, Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit e ka filluar funksionimin e tij në përmbushje të ligjit në shkurt të vitit 2019. Në përbërje të këtij komisioni janë pesëmbëdhjetë komisionerë, e gjithashtu pesëmbëdhjetë anëtarë të Sekretariatit Teknik.

Në ligjin 12/2018, mbi bazën e të cilit është ngritur ky komision, ka ndodhur një ndryshim, sikurse e përmendi edhe zonja kryetare, bazuar në ligjin 20/2019, sipas të cilit kanë ndodhur disa ndryshime të ligjit bazë, sipas të cilit është ngritur ky komision.

Absolutisht që dy ndryshimet kryesore janë ato që u përmendën pak më parë. Unë nuk do të kaloj në detaje, por ato lidhen sigurisht me fishën që ne do të votojmë. Ka pasur disa ndryshime në këtë fishë. Gjithashtu, lidhet edhe me afatin kohor, brenda të cilit supozohet që ta përfundojmë punën tonë ne si Komision i Jashtëm i Vlerësimit.

Këto janë dy ndryshimet thelbësore.

Tashti do të doja të vazhdoja një përshkrim të punës, që Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit ka bërë gjatë kësaj kohe. Do të doja ta ndaja punën në dy periudha. Periudha e parë është shkurt-

maj 2019, që kanë qenë muajt e parë të punës së këtij komisioni. Gjatë kësaj periudhe kryesisht jemi trajnuar. Në përmbushje të neneve të ligjit, mbi bazën e të cilit është ngritur ky komision, supozohej që komisionerët dhe anëtarët e Sekretariatit Teknik të trajnoheshin në lidhje me punën që do të bënin.

Kryesisht, trajnimet kane ndodhur nga institucione ligjzbatuese, si Inspektoriati i lartë i Deklarimit të Pasurive, DSIK-ja, KPK-ja. Gjithashtu, trajnime kemi pasur edhe nga partnerë ndërkombëtarë, të cilët na kanë mbështetur në punën që tashmë po bëjmë.

Ndërkohë, në muajin maj, në fillim të muajit maj, ne jemi vendosur në ambientet e reja të punës, që ndodhen në mjediset e Gardës së Republikës. saktësisht në këtë kohë ka filluar edhe puna reale e këtij komisioni.

Duke qenë një institucion i ri, si fillim na është dashur të organizohemi brenda nesh, duke përpiluar dhe miratuar një rregullore të brendshme të funksionimit të këtij komisioni. Kemi përpiluar e miratuar gjithashtu një rregullore për hedhjen e shortit, që lidhet me subjektet që ne do të votojmë. Kemi hartuar edhe një rregullore, e cila lidhet me hapat proceduriale të unifikuar, të punës që ne do të bëjmë.

Më e rëndësishmja ka qenë krijimi i një faqeje zyrtare të këtij komisioni, e cila na ka ndihmuar të bëjmë publike punën e këtij komisioni. Po ashtu, vlen të theksojmë se në këtë faqe zyrtare të këtij komisioni kemi vënë një fokus shumë të madh në një rubrikë e cila lidhet me denoncimin. Pra, në faqen tonë ekziston rubrika “Denonco”, në të cilën publiku i gjerë është i ftuar të bëjë denoncime në lidhje me raste specifike. Meqë jemi këtu, vlen të theksojmë se deri më sot kanë filluar të vijnë denoncime në lidhje me raste të caktuara. Pra, mund të themi se kjo faqe funksionon.

Ndërkohë, në muajin qershor kemi hedhur shortin e parë. Ashtu sikundër ju e përmendët, në këtë short të parë janë shortuar 45 subjektet e para, emrat e të cilëve janë publikë në faqen zyrtare të komisionit. Në hedhjen e këtij shorti, përveç stafit të komisionit, pra përveç pesëmbëdhjetë komisionerëve dhe pesëmbëdhjetë anëtarëve të Sekretariatit Teknik, kanë qenë gjithashtu të ftuar edhe nga nënkomisioni juaj, saktësisht ka qenë zoti Vorpsi. Po ashtu kanë qenë të ftuar edhe nga partnerët ndërkombëtarë, nga PAMECA, ICITAP, që të ishin prezent në atë hedhje shorti, e sigurisht për të vijuar me transparencën e punës.

Në këtë dyzetepesëshe të parë, që është shortuar saktësisht në datën 3 qershor, janë shortuar titullarët kryesorë të tre institucioneve që ne do të votojmë, përkatësisht 31 emra nga Policia e Shtetit, 12 emra nga SHÇBA-ja, si dhe 2 emra nga Garda e Republikës. Këta janë emrat e parë, dhe puna aktuale që po bën komisioni lidhet saktësisht me këta subjekte.

Duhet të kemi parasysh se, bazuar në ligjin 12/2018, tri janë shtyllat kryesore të punës që do të bëjë ky komision, punë që lidhet me vlerësimin e subjekteve, që janë përkatësisht: kriteri i pasurisë; kriteri i figurës; kriteri i profesionalizmit.

Kjo është puna aktuale që po bëhet sot. Për ta shpjeguar shkurtimisht procedurën e punës, ne kemi nisur fillimisht kontaktimin me institucione të tjera, si dhe kemi nisur hetimin administrativ në lidhje me këta 45 subjekte.

Ky hetim është ende në vijim dhe nuk ka përfunduar ende. Presim që së shpejti të përfundohet për disa subjekte të caktuara.

Ndërkohë, do të doja të theksoja kontaktin që kemi pasur me partnerë ndërkombëtarë. Gjatë kësaj periudhe në ambientet e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit kanë ardhur përfaqësues nga Ambasada Amerikane. Kemi pasur një vizitë nga zonja ambasadore. Gjithashtu, na kanë vizituar përfaqësues të misionit PAMECA, ICITAP, OSCE, të cilët janë interesuar në lidhje me punën që ne bëjmë, në lidhje me problematikat që kemi hasur, si dhe në lidhje me ndihmesën që këto institucione mund të na japin.

Vlen të theksojmë se gjatë kësaj periudhe, nga pikëpamja strukturore dhe infrastrukturore, mbështetja kryesore që ne na është dhënë, sigurisht bazuar kjo edhe në ligj, ka ardhur nga Ministria e Brendshme.

Do të donim që si komision të vlerësonim shumë punën e bërë deri më tash. Megjithatë, në ushtrimin e detyrës sonë dua të sjell në vëmendjen tuaj disa problematika që kemi hasur në punën tonë.

Së pari, bazuar në ligjin 12/2018, mbi bazën e të cilit është ngritur ky komision, siç e thashë disa herë, në përbërje të komisionit janë pesëmbëdhjetë komisionerë dhe pesëmbëdhjetë anëtarë të Sekretariatit Teknik. Ndërkohë, nuk është parashikuar staf mbështetës për punët tona të përditshme administrative. Kjo është një nga mungesat e ne e kemi ndjerë gjatë kësaj kohe.

Ndërkaq, lidhur me procedurën e hetimit administrativ, mbështetur në nenet e ligjit 12/2018, të gjitha institucionet publike e private, të cilave ne u drejtohem, janë të detyruara të na përgjigjen brenda një afati kohor prej pesëmbëdhjetë ditësh. E vërteta është se kemi pasur vonesa. Kjo do të thotë se jo të gjitha institucionet, të cilave ne u kemi drejtuar, qoftë publike apo private, u janë përmbajtur këtij afati prej pesëmbëdhjetë ditësh. Kryesisht, kjo vonesë në përgjigjet e tyre është bazuar në dy momente: në momentin e parë është bazuar në fluksin e madh të punës që ka përgjigja; së dyti, është bazuar në një mosakordim të afateve kohore të ligjit tonë dhe afateve kohore të ligjeve, mbi bazën e të cilit operojnë këto institucione. Kjo është problematika tjetër që ne kemi hasur.

Në lidhje me disa institucione me të cilat ne bashkëpunojmë për marrjen e informacionit për punën e hetimit administrativ problematika të tjera kanë lindur në mënyrën se si jepen përgjigjet. Duke qenë se në fazën e parë këto përgjigje kanë qenë jo shumë të qarta, ka lindur një fazë e dytë, ku ne kemi ridërguar kërkesa të tjera për sqarimin e këtij informacioni që na ka ardhur. Kjo ka sjellë disa vonesa të tjera gjatë ecurisë së këtij procesi.

Dua të ndaloj edhe në një moment që lidhet me sigurinë, sidomos në këtë fazë që jemi, kur presim së shpejti të kalojmë në seanca dëgjimore, është ngritur një problem nga ana e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit që lidhet me sigurinë fizike të institucionit dhe të komisionerëve.

Së fundi, një nga problematikat e tjera që na ka lindur janë ndryshimet e vazhdueshme që ndodhin në radhët e institucioneve me të cilat ne bashkëpunojmë dhe duhet t'i vetojmë: Policinë e Shtetit, Gardën dhe SHÇBA-në, ku ndodhin ndryshime të vazhdueshme në stafin e tyre, Kjo do të thotë që ne kemi një listë fillestare të punonjësve, të cilët hyjnë në fashën e vetimit, janë tagër e këtij komisioni, ndërkohë që në vazhdimësi vijnë spostime të posteve brenda këtyre institucioneve, gjë që çon një në vendimmarrje të re për komisionin tonë. Kjo ishte një panoramë e përgjithshme e punës që ne kemi bërë deri tani.

Dua të shpreh të gjithë përkushtimin dhe angazhimin e të gjithë anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe të sekretariatit teknik, të cilët me përgjegjësi dhe me integritet të lartë moral po përballojnë sfidat e këtij procesi dhe përkushtohen që ta mbyllim sa më me sukses atë.

Jam në pritje të çfarëdolloj pyetjeje që keni.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit edhe nga ana jonë, zonja Kapaj, qoftë për informacionin e hollësishëm që na dhatë deri në këtë pikë, por edhe për gatishmërinë tuaj që në momentin e parë për të qenë pjesë e dhënies së informacionit në këtë nënkomision!

Do të doja t'ua kaloja fjalën kolegëve.

Po, zoti Vorpsi.

Sadi Vorpsi - Faleminderit, zonja kryetare!

Zonja Kapaj, vlerësoj maksimalisht atë që referuat për të gjithë punën e komisionit. Kam qenë pjesë e monitorimit të shortit që hodhët për 45 subjektet e para të vetimit. Kam parë edhe situatën, kushtet ku punoni. Lexova dhe raportin tuaj për mungesën e stafit ndihmës që realisht duhej të ishte menduar që në fillim, por duhet të shikohet tani me buxhetin e ri, që ta merrni këtë staf. Patjetër që ne do t'ju ndihmojmë për të zgjidhur këtë problem. Unë pashë se shqetësimet tuaja kryesore këtu në raport janë vonesat e përgjigjeve të

institucioneve të ndryshme. Do të doja të dija nga ju, se cilat janë këto institucione, që përgjithësisht ju kthejnë përgjigje ndoshta ndonjëherë të paqarta dhe që i tejkalojnë të gjitha afatet ligjore. Për vonesat e kthimit të përgjigjeve nga ana e disa institucioneve që kanë sjellë vonesa të hetimit administrativ sipas ligjit që kemi miratuar në vitin 2018 shprehimisht thuhet: “Brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës çdo organ shtetëror dhe ent publik detyrohet që të bashkëpunojë. Organet përkatëse të vlerësimit për dorëzimin, aksesin dhe verifikimin e të dhënave, faktet dhe rrethanat, mosbashkëpunimi ose referimi për të bashkëpunuar i këtyre vonesave të papërshtatshme të këtij procesi të vlerësimit t’i referohen prokurorisë si vepër penale”. A keni pasur raste të kësaj natyre, që këto raste t’i referoni në prokurori?

Ermonela Felaj - Po, zonja Kapaj.

Ana Kapaj – Faleminderit, zoti Vorpsi!

Një nga shqetësimet kryesore të 15 komisionerëve, janë vonesat në disa momente të shkresave, sepse në fund të fundit kjo vonesë çon në vonesën e punës sonë dhe asaj që ne jemi marrë dhe që duhet të bëjmë.

Ajo që ju lexuat në raportin e përgatitur, është një citim i saktë i nenit të ligjit që i referohet këtij afati 15 ditor. Problematika kryesore që ka lindur me disa institucione për vonesat lidhet kryesisht me faktin që në ligjet e këtyre institucioneve ose në ligjet që i janë atashuar funksionimit të këtyre institucioneve afatet kohore që kanë janë të ndryshme, gjë që do të thotë se për një institucion tjetër publik që pritet të na japë përgjigje ky afat nuk është 15 ditë, por ka afat 30 ditë ose 2-3 muaj. Secili institucion flet nga pozita e tij dhe e argumenton mbi bazën e tij ligjore dhe këtë gjë bëjmë edhe ne. Në shkresat fillestare që kemi nisur ndaj të gjitha institucioneve, kemi cituar saktësisht këtë pikë, këtë nen, të ligjit tonë, duke u shpjeguar këtyre institucioneve se kanë këtë detyrim, bazuar në ligjin tonë.

E vërteta është që përveç shkresave zyrtare që janë nisur nga ne dhe argumentimit që kemi dhënë, unë si kryetare në shumicën e rasteve e shoqëruar edhe nga komisionerët tanë kam filluar bisedimet me këto institucione për të mos arritur në atë që ju pyetët, në procedime penale, denoncime apo mosbashkëpunime midis nesh. E vërteta është se është arritur një kompromis, kemi pasur vonesa dhe jemi ende në pritje të disa përgjigjeve. Nëse do t’u referohemi institucioneve për të cilat kemi paqartësi në leximin e informacionit që marrim, unë këtu do të kërkoja nëse është e mundur, duke qenë se këto institucione ndaj të cilave jemi të paqartë në përgjigjet që lidhen me aspekte të sekretit të hetimit administrativ, nuk dua të citoj emrat e këtyre institucioneve, por, nëse duhet, do të kërkoj që kjo mbledhje të zhvillohet me dyer të mbyllura, pra bëhet fjalë për ato institucione që kanë një nivel të caktuar sigurie. Ndaj, si ta shikoni ju të arsyeshme.

Ermonela Felaj - Në fakt, ky nënkomision është i detyruar të procedojë me dyer të mbyllura, në rast se ne duhet të njihemi me një informacion të klasifikuar.

Ana Kapaj – Në rregull!

Ermonela Felaj – Kështu, unë nuk besoj se është ky rasti.

Pyetja, nëse mund të na e thoni, është se me cilat institucione keni hasur pengesa. Kjo nuk është për të penalizuar një institucion apo një tjetër, sepse ju e shpjeguat qartë në fjalën tuaj se ka edhe kolizione të ligjit që ju jeni të detyruar të operoni dhe ligjeve që operojnë institucionet. Natyrisht, për çdo institucion i pari është ligji organik, por, duke pasur parasysh që ju vini nga komiteti i pedagogëve, duke pasur parasysh punën e gjatë që keni si pedagogë, si dhe faktin që mund të keni pasur nxitje, ndoshta jo në mënyrë publike, që të merrni kontakte me drejtuesit e këtyre institucioneve, mbase do të ishte rasti që të kaloni në një hap tjetër. Pra, disa nga marrëveshjet me institucionet që keni të bëni më shumë, si dhe me institucionet pa të cilat puna nuk do të mund të ecte përpara, t'i bënit publike. Unë besoj se kjo gjë do të ndikonte në rritjen e detyrimit për secilën palë, për vetë institucionin, por edhe për ju për të qenë sa më operativë në punën tuaj. Pra, ju mund të na i përmendni se cilat janë këto institucione, sepse ne na intereson ky lloj informacioni, aq më tepër nëse këto institucione vijnë dhe përgjigjen në Komisionin e Sigurisë. Sigurisht, ne do të përpiqemi të bëjmë pjesën tonë.

Monitorimi nuk është se do të zëvendësojë punën tuaj, por monitorimi do të bëhet që ne të sigurohemi që ligji zbatohet, sipas qëllimit që ai është miratuar. Nuk e di, por besoj se përvoja e punës shpeshherë ju ka bërë të bini në kontakt me një thënie të famshme të njohur: “Të shikojmë çfarë ka dashur të thotë ligjvënësi”. Në rastin konkret ne jemi ata që kemi diskutuar për miratimin e atij ligji dhe secili nga ne këtu në këtë tavolinë i ka të qarta arsye pse u ngrit ky nënkomision.

Qëllimi i ngritjes së këtij nënkomisioni është pikërisht (vërtet është përdorur fjala “monitorim”) që ne të mos lejojmë që ligji të përdoret për gjueti shtrigash. Pra, nëse dikush duhet të largohet nga radhët e Policisë së Shtetit, do të largohet për arsye, të cilat tregojnë se figura e tij nuk ka arritur dot t'i rezistojë joshjes që vjen nga krimi apo nga rrethana të tjera. Pra, këtë të detyrë ka ky nënkomision: të sigurojë që puna juaj të jetë sa më objektive, e mbështetur në fakte dhe në argumente, në mënyrë që të mos ketë asnjë subjektivizëm, në kuptimin negativ të fjalës, apo asnjë ndikim tjetër në funksionimin e saj.

Ana Kapaj - Faleminderit, zonja kryetare!

Nëse do t'u referohemi disa institucioneve, me të cilat ne ende hasim vështirësi për marrjen e informacionit, momentalisht ne jemi në trataviva me Qendrën Kombëtare të Biznesit për firmosjen e një marrëveshjeje, e cila konsiston në kthimin sa më shpejt të përgjigjeve.

Gjithashtu, nga Prokuroria e Përgjithshme kemi mungesë në dhënien e përgjigjeve, gjë që na ka penguar në finalizimin e një hetimi. Ndërkohë, ne kemi hasur vështirësi edhe në leximin e informacionit që na kanë sjellë institucione të ndryshme, çka na ka çuar në një fazë të dytë të kërkimit të informacionit nga këto institucione. Kryesisht kjo lidhet me institucione, si SHISH-i.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Po, zonja Gjebrea.

Elona Gjebrea – Faleminderit për informacionin që dhatë!

Sigurisht për ne, si nënkomision, është shumë e rëndësishme, sikurse e tha edhe kryetarja, marrja e informacionit të detajuar lidhur me punën që po bën Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit. Duke dëgjuar edhe atë çfarë ju referuat në këtë komision, kam disa pyetje, sigurisht edhe shqetësime, të cilat do të doja t'i diskutoja këtu.

Sipas asaj çfarë ne kemi miratuar në ligjin e fundit, të ndryshuar, i cili mban datën 20.03.2019, ju keni një vit kohë për të bërë vlerësimin e 280 subjekteve. Mënyra apo hapat, që ju keni ndjekur deri tani, e vendosin në pikëpyetje punën tuaj nëse ky afat kohor është i mjaftueshëm apo jo.

Ju thatë se janë 280 subjekte në total, si dhe 30 anëtarë të komisionit teknik, duke përfshirë edhe sekretariatit teknik. Pra, afërsisht janë 9 subjekte për çdo trup. Sipas një llogarie të përafërt nga muaji prill (meqenëse ju thatë se 2 muaj keni bërë trajnime për përgatitjen tuaj të brendshme), për 6 muaj ka përfunduar puna për 45 subjekte, që i bie më pak se 20% e punës. Ndërkohë, kur për 6 muaj është bërë vetëm 20% e punës, si do të siguroni ju që 80% e punës do të arrihet për periudhën që ka mbetur? Pra, po flas për 7 muaj nga shtatori deri në mars. Sigurisht që kjo kërkon impenjimin tuaj maksimal. Pa dyshim, që ne i mirëpresim sa më shpejt raportimet konkrete për të gjitha subjektet, për të cilat ju thoni se keni vlerësuar deri tani, duke i mirëkuptuar edhe vështirësitë. Po ashtu, sikurse thanë edhe kolegët këtu, çdo institucion që sjell vonesa në këtë punë, që dalin nga taksat e çdo qytetari dhe nga buxheti i shtetit, duhet të përgjigjet me përgjegjësi, sigurisht duhet të mbajë edhe përgjegjësi në rast të vonesave, të cilat, pa dyshim, ju thoni se e cenojnë punën tuaj.

Nga ana tjetër, vura re që ju keni përgatitur një set me dokumente, që besoj se janë të domosdoshme për funksionimin e procesit, por nuk shikoj këtu që të keni një kod etike, që mendoj se është i domosdoshëm, por ndoshta është e përfshirë në një nga këto dokumente. Pyetja është: a keni parashikuar ju një kod etike, i cili mendoj se është shumë i domosdoshëm për këtë proces sensitiv, që, pa dyshim, duhet të ketë edhe një mirëkuptim dhe dakodësi të shkruar për të gjithë anëtarët e trupës së jashtme të vlerësimit?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Gjebrea!

Zonja Kapa.

Ana Kapaj – Faleminderit!

Duke iu referuar pyetjes së parë, ku ngrihet shqetësimi i respektimit të afatit kohor, tashmë 1-vjeçar, që ka ardhur si amendim i ligjit fillestar, me ligjin e dytë nr. 20/2019, kam përshtypjen se nga llogaritja e kohës që ne kemi bërë, që në momentin e miratimit, u botua dhe hyri në fuqi ky ligj, i referohemi, nëse nuk gaboj, muajit qershor të vitit 2018, afati ynë 1-vjeçar është respektivisht në fillim të muajit qershorit të vitit 2020. Pra, bazuar në ndryshimet që ka sjellë ligji i ri, ne presim që koha 1-vjeçare e funksionimit të këtij komisioni të jetë deri në qershor të 2020-ës.

Së dyti, si e kemi menaxhuar ne punën dhe si mendojmë të respektojmë këtë afat? E vërteta është se afati i ri 1-vjeçar ka sjellë një shqetësim të madh për të gjithë ne, për mirëfunksionimin e punës së këtij komisioni, sepse supozohet që një punë, e cila mendohej të bëhej në një kohë pak më të gjatë, tashmë duhet bërë brenda 1 viti. Ne kemi menduar një llogaritje kohore dhe e kemi aplikuar në shortimin e parë. Numri 45 i subjekteve, që ne kemi shortuar në shortin e parë ka lindur realisht si një llogaritje e kohës që kemi bërë, ku ka rezultuar se, nëse shportojmë 45 dosje çdo 2 muaj, ne arrijmë të respektojmë afatin deri në fund të qershorit. Me këtë llogaritje kemi ecur në fillimet tona. Tani që ne kemi marrë dosjet, kemi filluar punën, korrespondencën dhe po e shohim realisht punën që duhet të bëjmë, po shikojmë që puna është vërtet voluminoze.

Unë dua t'ju sjell në vëmendje një proces paralel, vetingun në gjyqësor, i cili bazohet, gjithashtu, në tri shtylla. Ky komision bën të njëjtën punë si ne, por në lidhje me shtyllën e parë, ky komision merr një informacion më të plotë për pasurinë nga inspektorati. Gjithashtu, në lidhje me shtyllën e figurës, komisioni i vetingut në gjyqësor merr një raport të plotë nga institucionet e tjera. Ne, ndërkohë, duhet ta bëjmë vetë që nga fillimi punën për të tria këto shtylla, që do të thotë se puna është vërtet shumë voluminoze dhe afati kohor është shqetësim për ne.

Unë ju siguroj se puna e komisionerëve dhe e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit është vërtetë serioze. Ne kemi qenë në punë që në qershor dhe deri tani që flasim, pavarësisht se në gusht supozohet që jemi me leje. Kemi qenë të gjithë në punë me periudha shumë të shkurtra pushimi. Të gjithë jemi seriozë për atë që duam të bëjmë dhe atë që duam të nxjerrim.

Punën e kemi nisur nga një llogaritje shumë e thjeshtë matematikore, duke menduar se deri në qershor, që është afati kohor, do të arrijmë të ezaurojmë të gjitha dosjet. Shpresojmë të

jetë kështu, por nuk e fsheh, shqetësimi juaj është i drejtë, sepse është shqetësim edhe për ne. Afati është vërtet shumë i ngushtë.

Ermonela Felaj – Zonja Gjebrea.

Elona Gjebrea – Për faktin se afati është i ngushtë, duke qenë se ju jeni titullare, duhet të merrni të gjitha masat, pasi keni një trupë prej 30 personash, të cilët nuk janë pak, dhe theksoj se paguhen me taksat e buxhetit të shtetit, të alokuar për këtë ligj, i cili nuk është pak.

Nga ana tjetër, sigurisht në kohë të tillë intensiteti pune nuk besoj se duhet diskutuar periudha e pushimeve, sepse me Kod Pune duhet të bësh një vit punë që të përfitosh nga leja e zakonshme. Ju keni filluar punën në prill. Sigurisht, mund të ketë pasur subjekte të cilët kanë qenë të punësuar më parë, por jo të gjithë, në dijeninë time, ndaj shpresoj që të gjithë të mirëkuptojnë rëndësinë që ka ky proces dhe çfarë ju keni në duar. Mendoj se duhet të bëni një kalendar agresiv e intensiv, që të mos kemi asnjë situatë surprizë, e cila do të sillte shumë kosto për buxhetin e shtetit, por dhe për të gjitha gjërat e tjera që vijnë më pas.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Gjebrea!

Nëse më lejon, dua të bëj një koment për këtë pikë.

Ne kemi pasur një debat për caktimin e afatit 1-vjeçar, por le të themi se e kemi menduar, nuk ka qenë ndonjë gjë e tipit “loja e kungulleshkës, pse 1, pse 2, pse 3”.

E para, kemi synuar që brenda një afati optimal të mund të vetohet trupa, në mënyrë që të mos ndjehet e shkëputur nga misioni kryesor i saj. Është e qartë se vetingu krijon një lloj spostimi të fokusit te secili nga personat, që duhet t’i nënshtrohen këtij procesi, por, nga ana tjetër, nuk është në interesin tonë dhe të publikut që kjo forcë të ndihet e tërhequr dhe ta harrojë misionin e vet kryesor, luftën kundër krimit. Neve na intereson që ky proces të ndodhë në një kohë sa më optimale.

E dyta, na intereson që ky proces të bëhet me një kosto sa më optimale, sepse kam parasysh se policia nuk ka thjesht vetëm këtë nevojë në misionin e saj të përditshëm, por edhe shumë të tjera.

Në funksionin tonë, si anëtarë të Komisionit të Sigurisë, ne kemi marrë kontakte të herëpashershme pothuajse me të gjitha drejtoritë e policisë, pika të ndryshme të kalimit kufitar, institucione apo organe të cilat hyjnë në përgjegjësinë e Ministrisë së Brendshme. Këtë nuk e kemi bërë kot, por për të kuptuar se cilat janë vështirësitë që ata kanë për të orientuar Ministrinë e Brendshme, që në rastin e projektimit të buxhetit të shtetit që bëhet çdo vit të adresohen nevojat bazë nëpunës së tyre dhe jo të tjerat.

E treta. Ne kemi pasur edhe një përvojë të njohur, siç është ajo e komisioneve të vetingut për gjyqtarët dhe prokurorët, sigurisht ka qenë edhe një përvojë e re për të gjithë ata komisionerë nuk është se e kanë njohur më parë. Pra, mund të themi që para 2-3 vjetësh edhe ata kanë qenë si në fillimet tuaja sot, edhe ne kemi bërë një llogari tonën në mënyrë që të vinim te ky afat. Mua më vjen mirë ta dëgjoj nga goja juaj që ju jeni kujdesur që ta keni parasysh këtë gjë dhe ta bëni si llogari në punën tuaj. Ajo që na takon ne si nënkomsion është fakti se ndoshta jo të gjitha institucionet e kanë kuptuar rëndësinë e punës suaj, por mendoj se ata nuk duhet të kursehen dhe ne patjetër do t'i nxisim në këtë drejtim që askush të mos i mungojë përgjigjes.

Ndërkohë, dua të ndalem te dy momente, të cilat më shumë i kam jo si pyetje, por si diskutim.

Ju thatë se keni vështirësi, pasi njerëzit ndryshojnë pozicionet e punës, ndërkohë që ne mund ta kemi të shortuar dhe të kemi filluar punën. Ndryshimi i pozicionit të punës, në mos gaboj, nuk të çon në ndryshimin e gradës, pasi puna juaj është e lidhur me gradën. Unë e di këtë gjë, prandaj do të doja ta ndaja me ju. A mund t'i bëni ju pjesë të Rregullores të gjitha këto momente (mendoj që duhet ta bëni) të funksionimit tuaj?

Sigurisht që ka një praktikë pune, e cila të ekspozon përpara rasteve të ndryshme dhe për të cilat ti detyrohesh të japësh një zgjidhje, por kjo zgjidhje duhet të jetë konsistente edhe për raste të ngjashme që mund t'ju ndodhin në të ardhmen.

Si pikë të parë do të doja që ju këtë ta reflektonit në Rregullore, sepse pavarësisht se ti mund ta ndryshosh pozicionin e punës, ke gradën dhe është grada ajo që ka përcaktuar vendosjen tënde në veting nga Komision i Jashtëm. Nuk do të doja që rasti të ishte që lëvizët nga puna për t'i "shpëtuar" vetimit nga Komisionit i Jashtëm dhe për ta kaluar vetimin në një fazë tjetër së bashku me punonjësit që kanë gradat e mesme ose kanë grada të ulëta.

Sidoqoftë, nëse kjo gjë është problem neve do të na duhet ta diskutojmë më tej edhe me ministrin e Brendshëm, prandaj ishte e nevojshme që ta kishim sot.

E dyta, në përcaktimin e një viti ne kemi pasur parasysh që ju nuk do të kishit shumë vështirësi në marrjen e informacionit. Pse? Sepse gradat e larta kanë qenë pjesë e detyrimit për ta raportuar pasurinë në mënyrë periodike, ashtu siç raportojmë të gjithë, ndërkohë që do të ketë problem me gradat e mesme dhe të ulëta, sepse ato nuk kanë pasur detyrim dhe tani ligji i detyron të raportojnë për pasurinë për një periudhë kohore shumë të gjatë dhe kjo gjë ka vështirësitë e saj në gjetjen e dokumenteve, një pjesë e tyre mund të jenë zhdukur, mund të mos jenë mbajtur e të tjera me radhë.

Ju në punën tuaj si organizoheni dhe si debatoni për të zgjidhur probleme të kësaj natyre? Me këtë rast do të desha të specifikoni edhe kohën kur ju keni nisur nga puna si kryetare e Komisionit të Jashtëm të Vetimit.

Faleminderit!

Ana Kapaj – Faleminderit, zonja kryetare!

Sa i takon pikës së parë që ju hapët si diskutim, nëse do të ishte mirë që ne të reflektonim në Rregullore gjërat që ju specifikuat, si dhe në lidhje me vetimin që ne duhet t'u bëjmë subjekteve të caktuara bazuar në gradë, bazuar në ligj, saktësisht në nenin 6 të ligjit nr. 12/2018, subjektet që ne vetojmë bazohen jo vetëm në gradë, por edhe në pozicion. Këto janë dy kriteret që janë të specifikuar në ligj dhe ky komision i ka marrë në konsideratë. Është besimi i plotë i anëtarëve të këtij komisioni ajo që ju thatë. Pra, pavarësisht që subjekti që është shortuar, ka ndryshuar pozicionin, nëse ai e ruan gradën, sigurisht që ai e ruan gradën, të vazhdojë të jetë pjesë e këtij procesi. Kjo në fillimet tona ka pasur debat dhe këtë gjë e kemi diskutuar midis nesh disa herë, megjithatë në fazën që jemi subjektet janë pozicionuar në trupat e vlerësimit dhe për çdo subjekt trupa e vlerësimit dhe relatori përkatës merr vendimmarrjen finale. Sigurisht i lihet trupës së vlerësimit një vendimmarrje finale nëse ky subjekt, pavarësisht nga ndryshimi i pozicionit që ka ndodhur, do të vazhdojë të vetohej, apo jo.

Unë ju siguroj që për sa kohë subjekti e mbart gradën me vete, kjo gjë ndodh, ky subjekt vazhdon të jetë pjesë e këtij procesi. Ne jemi treguar shumë të kujdesshëm në mënyrë që t'i evitojmë këto situata që ju përmendët, që nga një spostim qoftë edhe momental i pozicionit ta anashkalojmë këtë proces kaq të rëndësishëm. Kjo është diçka me të cilën jemi hasur paraprakisht dhe e kemi diskutuar midis nesh, realisht kemi pasur edhe raste të tilla në komisionin tonë. Unë mendoj se është me vend ta raportoj në këtë nënkomision si një nga problematikat që kemi hasur. Sigurisht, procesi do të jetë më i thjeshtë nëse e fillojmë me këtë numër dhe këta emra subjektsh dhe vazhdon kështu deri në fund. Procesi mund të ngjallë disa komplikacione gjatë rrugës nëse kemi lëvizje, sepse na çon ne në vendimmarrje të ndërmjetme. Pra, ne ose trupa e vlerësimit duhet të marrim një vendim nëse ky subjekt që është shortuar në krye të herës, por ka ndërruar pozicionin gjatë kohës, duhet të vazhdojë apo jo t'i nënshtrohet procesit të vetingut. Kjo sa i takon pikës së parë.

Sugjerimi që ju jepni është shumë i rëndësishëm dhe unë do ta shtroj në komision, sepse lidhet me reflektimin e këtij momenti në rregulloren tonë të brendshme.

Në lidhje me pikën e dytë, e cila lidhet me pasurinë dhe me atë që ju thoni për titullarët e lartë që kanë bërë deklaram të pasurisë në kohë, kjo është e vërtetë, titullarët e lartë kanë bërë deklaram të pasurisë në kohë, por duhet të kemi parasysh që pozicioni dhe puna jonë si

Komision i Jashtëm i Vlerësimit është që të bëjmë verifikime mbi këtë pasuri që ata kanë deklaruar. Pra, ne marrim të mirëqena deklaratat e tyre, deklarata veting që ata kanë bërë, që është shtojca 1, që ata kanë plotësuar në krye të herës, si dhe informacion për deklaratimet e tyre në vite nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Pasurive, nëse ka, dhe sigurisht ka pasur deklarime në vitet për titullarët e lartë, me të cilët ne po merremi aktualisht. Pasi i marrim këto dy tipologji deklarimesh, ne bëjmë krahasimin mes tyre dhe më pas shtrijmë hetimin tonë për verifikime të mëtejshme. Pra, në rolin tonë si komisionerë, nuk marrim të mirëqenë atë që ata deklarojnë, por nisemi nga ajo që ata deklarojnë dhe bëjmë hetimet tona në institucione, pasi kemi çuar kërkesën për të vërtetuar nëse ky deklarim që ka bërë subjekti është i vërtetë apo jo. Sigurisht, verifikimi është ai që na merr kohë.

Nuk e di nëse isha e qartë!

Nëse më lejoni, zonja më bëri pyetje që lidhet me Kodin e Etikës. Realisht, ne nuk kemi një Kod Etike, ose nuk kemi miratuar një Kod të tillë më vete. Momente të caktuara që lidhen me etikën, me sjelljen e komisionerëve dhe anëtarëve të Sekretariatit Teknik përgjatë procesit të punës, janë momente që ne i kemi përfshirë në rregulloren tonë të përgjithshme.

Sigurisht, është një moment për t'u vlerësuar nëse duhet të ndërmarrim apo jo një Kod Etike më vete, por ju siguroj që në atë që ne kemi miratuar si rregullore të përgjithshme të funksionimit tonë si komision, ka elemente që përfshijnë mirëfunksionimin dhe sjelljen etike të komisionerëve dhe anëtarëve të sekretariatit teknik.

Ermonela Felaj – Edhe një pyetje të fundit, ju lutem!

A ka pasur ndonjë kërkesë për përjashtim të ndonjë prej komisionerëve nga 45 subjekte të shortuar gjatë kësaj periudhe dhe nëse po, si është operuar me vendimmarrjen?

Ana Kapaj – E vërteta është që deri në këtë moment që po flasim, nuk ka pasur asnjë ankesë të ardhur në komision, që të më drejtohet mua, prej asnjë nga subjektet që ne kemi në fishën e parë të vetimit. Realisht nuk kam pasur ankesë të asnjë lloj niveli nga subjektet, aq më tepër që të lidhet me komisionerët.

Ermonela Felaj – Është një gjë e mirë, sepse tregon për një fillim të mbarë të punës.

Pyetja tjetër, nuk e di nëse e kuptova drejt, e kishit shqetësim apo e keni ende shqetësim, nëse ka lëvizje të anëtarëve të Komisionit të Jashtëm, domethënë, anëtarë që fillojnë punën, largohen apo jo? A janë definitivë ata? Ka probleme të kësaj natyre?

Ana Kapaj – Realisht kjo është një pikë që unë nuk iu referova, megjithatë, duke qenë se e ngritët, ju falënderoj dhe sigurisht që do t'i përgjigjem.

E vërteta është që ka pasur lëvizje. Në 30-shen tonë fillestare, e këtu u referohem 15 komisionerëve dhe 15 anëtarëve të Sekretariatit Teknik, ka pasur lëvizje. Nuk di të t'ju them

një përqindje, do të ishte mirë ta kisha diçka të saktë, por ka pasur lëvizje edhe nga anëtarët e Sekretariatit Teknik, çka ka bërë që me largimin e një anëtari të këtij sekretariati, lista është spostuar dhe është zbritur në anëtarët në zbritje të Sekretariatit Teknik. Në mos gaboj, kemi pasur 2, 3 të tilla dhe momentalisht në zyrën time ka një tjetër kërkesë për dorëheqje, e cila do të përcillet dhe do të kërkohet zëvendësimi, ndërkohë që ka pasur dorëheqje edhe në nivelin e komisionerëve.

Ermonela Felaj – Kjo përgjigje e bën të detyrueshme, në fakt, sugjerimin që tha zonja Gjebrea, që ju duhet të keni një Kod Etik, sepse, normalisht, kushdo që merr përsipër të bëjë një detyrë, siç është detyra e të qenit anëtar i një komisioni të rëndësishëm, ka edhe përgjegjësi në ushtrimin e saj. Nuk mund të ndodhë që unë e filloj detyrën dhe largohem në një moment të caktuar, sepse është logjike që kjo prish gjithë procesin.

Elona Gjebrea – Në fakt, është shqetësim që ia vlen të merret në konsideratë. Kodi i Etikës është shumë i domosdoshëm dhe mendoj se, në qoftë se këta anëtarë marrin përsipër këtë detyrë, kanë kaluar përmes një procesi filtrimi me intervista dhe CV, ata duhet të angazhohen me shkrim që për një vit do të punojnë në këtë komision dhe do të ketë penaltete në rast se ata nuk vazhdojnë punën, për të cilën paguhen nga buxheti i shtetit. Këtë e theksoj, është shumë e domosdoshme, buxheti i shtetit ka pasur jo pak kosto për të krijuar këtë sistem të vetingut dhe monitorimit të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, kështu që mendoj që ju, si titullarë, patjetër që do të gjeni të gjithë mekanizmat që të minimizohet.

Fakti që ju thatë se nuk ju kujtohet, mendoj se ka më shumë se 2, 3 apo 4 kërkesa, dhe kjo pa dyshim e vë në vështirësi të gjithë punën tuaj, dhe ndoshta reflektohet në vonesat që referuat.

Ju faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Gjebrea!

Besoj që këtu mund ta mbyllim diskutimin në lidhje me raportimin e kryetares së Komisionit të Jashtëm të Vetëingut në radhët e Policisë së Shtetit.

Duke ju falënderuar për komunikimin ju vëmë në dijeni që në një kohë të afërt nënkomisioni do të jetë prezent në ambientet tuaja të punës për të pasur një bashkëbisedim më të gjerë me të gjithë anëtarët e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit. Qëllimi është i qartë, duam të performoni sa më mirë të jetë e mundur, me qëllim që puna juaj të jetë një vlerë e shtuar në raport me cilësinë që duhet të kenë të gjithë ata që bëhen pjesë e Policisë së Shtetit.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA